



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



01 Nr 360/01-64524 dt. 17.12.2021

Në vështrim të nenit 58, paragrafi 1, nënparagrafi h të Ligjit Vetëqeverisjes Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 3 pika 1.1, nenit 9 Ligjit Nr.03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit dhe Udhëzimet Administrative, nenit 2, nenit 20 të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, Vendimit të Qeverisë Nr. 02/46, të dt. 30.11.2021, për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e Pandemisë COVID-19, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë _____ 2021 të aprovoi këtë:

POPOZIM VENDIM

Për lirimin nga qiraja joprofitabile për familjet përfituese të shfrytëzimit të përkohshëm të banimit social në Bllokun I dhe II në Drenasin III për vitin 2022

Neni 1

Me këtë propozim vendim, kërkohet lirimi i familjeve përfituese të shfrytëzimit të përkohshëm social në Bllokun I dhe II në Komunën e Drenasit nga obligimi i pagesës së qirasë joprofitabile për vitin 2022.

Neni 2

Familjet e liruar nga qiraja joprofitabile për vitin fiskal 2022 janë të përcaktuara/përfshira në Vendimet e Kuvendit Komunal 12Nr.360-68569 të datës 29.11.2019, Vendimit 12Nr. 360/02-9351, të dt. 26.02.2021, si dhe Vendimin Nr. 12-360/01-28743, mbi lidhjen e Kontratave për dhënjën në shfrytëzim të përkohshëm të banesave në Banimin e Përkohshëm Social, në Bllokun I dhe II në Drenasin III.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale, Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 4

Ky propozim vendim hyn në fuqi pas aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.


KRYETARI I KOMUNËS

Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Duke pasur parasysh situatën e krijuar pas shfaqjes së Pandemisë COVID-19 (virusit SARS CoV-2), Vendimit të Qeverisë Nr. 02/46, të dt. 30.11.2021, për masat e përgjithshme dhe të veqanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e Pandemisë COVID-19, Vendimeve dhe Urdhëresave të Ministrive përkatëse lidhur me masat për parandalimin e virusit, rekomandimeve të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik (IKSHP) dhe Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) për ndërmarrjen e masave për parandalimin e pandemisë, kërkohet lirimi nga pagesa e qirasë joprofitabile për të gjitha familjet përfituese të shfrytëzimit të Banimit të Përkohshëm Social në Bllokun I dhe II, në Drenasin III për vitin 2022, familje këto të përfshira në vendimin 12Nr.360-68569 të datës 29.11.2019 të Kuvendit Komunal të Komunës së Drenasit si dhe Vendimeve 12Nr. 360/02-9351 të dt. 26.02.2021 e Vendimit Nr. 12-360/01-28743.

Ky propozim drejtohet duke pasur parasysh gjendjen sociale- shëndetësore të këtyre familjeve, si dhe vështirësitë ekonomiko- financiare të shkaktuara gjatë periudhës së pandemisë COVID-19.